



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

DREJTORIA E KOORDINIMIT DHE ÇËSHTJEVE LIGJORE
Sektori i Koordinimit dhe Planifikimit Strategjik

Raporti 4-mujor i monitorimit të Programit të Statistikave Zyrtare¹ (Maj-Gusht, 2023)

¹ Ky raport hartohet në zbatim të Nenit 17, pika 5 të Ligjit nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”. Në mbështetje në nenit 17, pika 5 e Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT ka përgjegjësinë për t’i paraqitur Këshillit të Statistikave raporte të shkurtra 4-mujore për ecurinë e zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare.

INSTAT - Instituti i Statistikave

Tel+(355) 4 2222411
+(355) 4 2233356
Fax+(355) 4 2228300

Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H. 1, Nj.A. Nr.2, 1017,
Tiranë, Shqipëri

info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	3
Treguesit e performancës së SKS në zbatim të objektivave zhvillimorë 2022-2026.....	4
Zbatimi i PSZ Maj-Gusht, 2023.....	5
Fusha statistikore 1: Statistikat Sociale dhe Demografike	7
Fusha statistikore 2: Statistikat Ekonomike	12
Fusha statistikore 3: Statistikat Sektoriale	17
Fusha statistikore 4: Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain	26
Menaxhimi i Cilësisë	30
Analiza e risqeve.....	31
Regjistrat e biznesit	32

Hyrje

Programi i Statistikave Zyrtare është dokumenti bazë që parashikon prodhimin e statistikave zyrtare nga Sistemi Kombëtar Statistikor të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë. Monitorimi i ecurisë së programit është element shumë i rëndësishëm për garantimin e plotësimit të aktiviteteve statistikore të parashikuara në të.

Ligji nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” parashikon si një ndër instrumentet monitoruese raportimin periodik me bazë 4-mujore.

Raporti 4 - mujor mbi zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare (PSZ) për periudhën Maj-Gusht, 2023, është përgatitur në bashkëpunim me agjencitë e tjera statistikore, të cilat kanë dhënë informacion për modulet statistikore nën përgjegjësinë e tyre sipas programit. Ky raport i referohet zbatimit të Planit Vjetor të PSZ për vitin 2023, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me vendim nr. 3/2023 “Për miratimin e Planit Vjetor 2023 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026”, dhe përmban në strukturën e tij një informacion të shkurtër mbi ecurinë 4 - mujore të treguesve strategjikë si matës afatshkurtër të ecurisë së Sistemit Kombëtar Statistikor në drejtim të zbatimit të objektivave strategjikë 2022-2026, si dhe një informacion më të detajuar të ecurisë së aktiviteteve statistikore të planifikuara për secilën fushë për 4-mujorin referencë. Ecuria e aktiviteteve statistikore monitorohet nëpërmjet raportimit të zbatimit të afateve të katër fazave kryesore të prodhimit statistikor: grumbullimi, përpunimi, publikimi i të dhënave, si dhe transmetimi i tyre në Eurostat. Gjithashtu, për çdo aktivitet përcaktohet niveli i detajimit të të dhënave sa i përket disagregimit (mikro, makro) si dhe niveli gjeografik i tyre. Gjithashtu, për çdo aktivitet jepet dhe niveli i përputhshmërisë me standardet e Eurostatit, raportim i cili bazohet në vlerësimin e fundit sipas SMIS+. Për çdo fushë statistikore raportohen edhe aktivitetet statistikore për të cilat të dhënat nuk janë grumbulluar, përpunuar apo publikuar në kohë, shoqëruar me arsyen e moszbatimit të afateve. Pjesë e raportimit janë dhe aktivitetet statistikore nga të cilat nuk prodhohen të dhëna statistikore si dhe aktivitetet e porealizuara gjatë periudhës së raportimit.

Raportet 4 - mujore për zbatimin e PSZ janë dokumentet bazë të cilat paraqiten nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT për Këshillin e Statistikave dhe shërbejnë për hartimin e Raportit Vjetor i cili i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë.

Progres-Raporti Maj-Gusht, 2023

Gjatë periudhës Maj-Gusht, 2023, tre agjencitë statistikore, INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë angazhuar për realizimin e aktiviteteve statistikore që kanë nën përgjegjësi sipas Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026.

Treguesit e performancës së SKS në zbatim të objektivave zhvillimore 2022-2026

Duke qenë se në Programin e Statistikave Zyrtare 2022-2026 janë përfshirë objektivat zhvillimore strategjikë, Sistemit Kombëtar Statistikor i lind detyrimi i raportimit në nivel 4 mujor mbi aktivitetet e kryera në drejtim të këtyre objektivave, performanca e të cilëve matet nëpërmjet treguesve respektivë.

Më poshtë paraqitet tabela me vlerat e treguesve për periudhën Maj-Gusht, 2023, në një qasje krahasimore me vlerat e pritshme për vitin 2023.

Ecuria 4 mujore e treguesve strategjikë Maj-Gusht, 2023

Objektivi	Treguesi	Vlera për periudhën Maj-Gusht, 2023	Target line 2023
Objektivi strategjik 1: Zhvillimi i SKS për të përmbushur plotësisht <i>acquis communautaire</i> lidhur me statistikat dhe të mbështesë plotësisht procesin e integritimit Evropian	1.2 Numri i akteve të reja ligjore të përafruara me <i>acquis</i> (Sipas PKIE)	0	4
	1.3 Rekomandime të Eurostatit (nga raporti <i>Peer Review 2018</i>), të zbatuara (në %)	89%	100%
Objektivi strategjik 2: Plotësimi i nivelit të plotë të kërkesave të përdoruesit për statistika zyrtare	2.2 Numri i vizitave në faqen e internetit të INSTAT-it	1,711,380	3,937,771
	2.6 Numri i aktiviteteve statistikore të disagreguara në nivel minimal vendor	2	11
Objektivi strategjik 3: Prodhimi i statistikave zyrtare të një niveli të lartë cilësie, që të përputhen me standardet e pranuar Evropiane	3.2 Numri i raporteve të cilësisë të publikuara	15	42



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

dhe ndërkombëtare			
Objektivi strategjik 4: Përfshirja e institucioneve shtesë prodhues në Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare	4.2 Numri i institucioneve furnizuese me të dhëna administrative mikro	4	4
	4.3 Numri i temave të trajnimeve të organizuara nga INSTAT	1 i planifikuar 6 Ad Hoc (1 Salstat dhe 5 per Cens)	12
Objektivi strategjik 5: Modernizimi i mëtejshëm i proceseve, metodave, produkteve dhe shërbimeve statistikore për të përmirësuar cilësinë, dorëzimin në kohë dhe efikasitetin në kosto të statistikave zyrtare	5.3 Numri i aktiviteteve statistikore tek të cilat përdoren software	54	99
Objektivi strategjik 6: Rritja e besimit të publikut në SKS dhe njohja e tij si strukturë institucionesh me performancë të duhur dhe profesionalisht të pavarur	6.2 Numri i referimeve ndaj produkteve të SKS-së në media, p.sh., në gazetatat ditore kryesore ose në televizione	8862	3.000

Zbatimi i PSZ Maj-Gusht, 2023

Për periudhën Maj-Gusht, 2023, janë parashikuar 54 aktivitete për prodhimin e 64 produkteve statistikore, ndërkohë janë realizuar 56 produkte statistikore.

Ndarja e aktiviteteve statistikore sipas Agjencive Statistikore rezulton të jetë:

INSTAT: përgjegjës për 47 aktivitete statistikore për prodhimin e 58 produkteve statistikore.

Banka e Shqipërisë: përgjegjës për 6 aktivitete statistikore për prodhimin e 5 produkteve statistikore.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë: përgjegjës për 1 aktivitet statistikor për prodhimin e 1 produkti statistikor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rezultatet për 4-mujorin referencë sipas fazave të prodhimit statistikor, janë si më poshtë:

- *Grumbullimi i të dhënave:*
 - Planifikuar grumbullimi i të dhënave për 94 produkte statistikore
 - Grumbulluar të dhënat në kohë për 92 produkte statistikore
 - 38 vrojtime: 33 PAPI dhe 5 CAPI
 - 32 burime administrative: 18 mikro; 8 makro; 6 kombinuar (mikro+makro)
 - 5 burime të kombinuara: 3 mikro; 2 kombinuar (mikro+makro);
 - 16 burime të tipit “tjetër: burime administrative+regjistra+databaza;
 - Nuk janë grumbulluar të dhënat në kohë për 2 produkte statistikor.
- *Përpunimi i të dhënave:*
 - Planifikuar përpunimi i të dhënave për 91 produkte statistikore;
 - Përpunuar të dhënat në kohë për 89 produkte statistikore.
 - Nuk janë përpunuar të dhënat në kohë për 2 produkte statistikor
- *Publikimi i të dhënave*
 - Planifikuar realizimi i 64 Publikimeve statistikore;
 - Realizuar 59 publikime statistikore;
 - Nuk janë realizuar në kohë 5 publikime statistikore.
- *Niveli gjeografik i të dhënave:*
 - Për 47 produkte statistikore të dhënat janë në nivel kombëtar;
 - Për 4 produkte statistikore të dhënat janë në nivel rajoni;
 - Për 3 produkte statistikore të dhënat janë në nivel qarku;
 - Për 1 produkt statistikor të dhënat janë në nivel qarku+kombëtar;
 - Për 1 produkt statistikore të dhënat janë në nivel rajon+qark+kombëtar;
 - Për 3 produkt statistikor të dhënat janë në nivel bashkie;
- *Transmetimi i të dhënave në Eurostat*
 - Janë transmetuar të dhënat për 42 produkte statistikore

Përsa i përket nivelit të përputhshmërisë me Eurostat rezultton:

- 3 produkte plotësisht në përputhje
- 2 produkte me nivel të lartë përputhshmërie;
- 17 produkte me nivel të mesëm përputhshmërie;
- 20 aktivitete me nivel të ulët përputhshmërie;

Më poshtë paraqitet në mënyrë të detajuar ecuria e realizimit të aktiviteteve statistikore për secilën fushë statistikore sipas 4 fazave: grumbullim, përpunim, publikim, transmetim të dhënash.



Fusha statistikore 1: Statistikat Sociale dhe Demografike

Statistikat sociale përfshijnë një sërë fushash që lidhen me statistikën e popullsisë, tregut të punës dhe pagave, arsimin, shëndetësisë, të ardhurave dhe shpenzimeve të konsumit, mbrojtjes sociale, drejtësisë dhe krimit, kulturës, si dhe përdorimit të kohës.

- Objektivi kryesor i statistikave sociale është që të sigurojë të dhëna në kohë dhe me cilësi të lartë të treguesve statistikorë, të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave sociale dhe ekonomike me qëllimin final të zhvillimit dhe përmirësimit të mirëqënies shoqërore, si dhe në monitorimin e impaktit të këtyre politikave në aspektet e ndryshme të jetës në vend.

Agjencia statistikore përgjegjëse: INSTAT

Për periudhën Maj-Gusht, 2023, për këtë fushë statistikore, janë 14 aktivitete që kanë të planifikuar në këtë 4-mujor mbylljen e të paktën një prej fazave të prodhimit statistikor. Gjatë kësaj periudhe është planifikuar finalizimi (publikimi) i 12 produkteve statistikore, nga të cilat janë finalizuar (publikuar) 5 produkte statistikore.

*Numri i produkteve statistikore që janë listuar në fazat e mëposhtme (grumbullim / përpunim / publikim / transmetim) është i ndryshëm sepse 1 produkt statistikor mund të ketë në këtë periudhë mbyllje të 1,2,3 ose 4 fazave të prodhimit statistikor.

1. Grumbullimi i të dhënave:

- **Planifikuar grumbullimi i të dhënave për 11 produkte statistikore**
- **Grumbulluar të dhënat në kohë për prodhimin e 10 produkteve të mëposhtme statistikore:**
 1. Statistikat Vitale, T2 - 2023
 2. Statistikat e Azilit
 3. Statistikat e të huajve
 4. Statistika të Fitimeve dhe Kostos së Punës
 5. Statistikat mbi Pagat, T1 - 2023
 6. Statistika nga Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2023
 7. Statistika mbi Ndhimën ekonomike, K1 - 2023
 8. Statistika të Aftësisë së kufizuar, K1 - 2023
 9. Statistika të Pagesës së papunësisë, T2 - 2023
 10. Statistika të ESSPROS - Sistemi bazë ESSPROS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- Për 2 produkte statistikore të dhënat janë grumbulluar me anë të vrojtimeve, ku për 1 produkt është përdorur metoda PAPI, ndërsa për 1 produkt tjetër është përdorur metoda CAPI
- Për 8 produkte statistikore të dhënat janë marrë nga burime administrative, ku për 1 produkt të dhënat janë mikro, për 1 produkt të dhënat janë makro dhe për 6 produkte të dhënat janë të kombinuara (makro+mikro).


➤ **Nuk janë grumbulluar të dhënat në kohë për produktin e mëposhtëm:**

- Statistikat e Shëndeti publik

Arsyeja e moszbatimit të afatit: Mungesa e të dhënave nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Masat e marra: Komunikime të vazhdueshme me përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për sigurimin e të dhënave. (Të dhënat kanë ardhur pas periudhës së raportimit.)

Grafiku 1.1 Përmbledhja e fazës së grumbullimit për fushën: Statistikat Sociale dhe Demografike



2. Përpunimi i të dhënave

- **Planifikuar për tu përpunuar të dhënat për 10 produkte statistikore**
- **Përpunuar të dhënat në kohë për prodhimin e 9 produkteve statistikore të mëposhtme:**

1. Statistikat Vitale për T2 - 2023
2. Statistikat e Azilit
3. Statistikat e të huajve
4. Statistika të Forcave të Punës, T1 - 2023
5. Statistika të Tregut të Punës, T1 - 2023
6. Statistikat mbi Pagat, T1 - 2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

7. Ndhimja ekonomike, K1 - 2023
8. Statistika të Aftësisë së kufizuar, për K1 - 2023
9. Statistika të Pagesës së papunësisë, për T2 - 2023

➤ **Nuk janë përpunuar të dhënat në kohë për produktin e mëposhtëm:**

- Statistikat e Shëndeti publik

Arsyeja e moszbatimit të afatit: Mungesa e të dhënave nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Grafiku 1.2 Përmbledhja e fazës së përpunimit për fushën: Statistikat Sociale dhe Demografike



3. Publikimi i të dhënave

- **Planifikuar publikimi i të dhënave për 12 produkte statistikore**
- **Realizuar në kohë publikimi (njoftimi për shtyp, tabela e përditësuar, databaza e përditësuar) për 8 produktet statistikore të mëposhtme:**
 1. Treguesit Demografikë, T1 - 2023
 2. Treguesit Demografikë, T2 - 2023
 3. Azilkërkuesit në Shqipëri, 2022
 4. Të huajt në Shqipëri, 2022
 5. Anketa Tremujore e Forcave të Punës, T1 - 2023
 6. Të dhëna administrative të tregut të punës, T1 - 2023
 7. Statistikat e Pagave T1 - 2023
 8. Statistika të Diplomimeve

*Është publikuar botimi i përgjithshëm “Burra dhe Gra”

- Për 5 produkte statistikore të dhënat janë në nivel kombëtar
- Për 1 produkt statistikor të dhënat janë në nivel qarku / kombëtar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- Për 2 produkte statistikore të dhënat janë në nivel qarku

➤ **Të dhënat nuk janë publikuar në kohë për 4 produktet e mëposhtme:**


- Statistikat e Shëndeti publik

Arsyeja e moszbatimit të afatit: Mungesa e të dhënave nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

- Statistikat e Ndhmës ekonomike,
- K1 - 2023; Statistika të Aftësisë së kufizuar, për K1 - 2023;
- Statistika të Pagesës së papunësisë, për T2 - 2023

Arsyeja e moszbatimit të afatit: Për të mos cënuar cilësinë statistikore, statistikat e kësaj kategorie nuk janë publikuar në kohë për arsye të nevojës për *cross-check* dhe verifikimit të burimeve administrative, si dhe është duke u analizuar gjithashtu mundësia e rishikimit të formatit të publikimit.

Grafiku 1.3 Përmbledhja e fazës së publikimit për fushën: Statistikat Sociale dhe Demografike



4. Transmetim

-Janë transmetuar në Eurostat të dhënat mbi:


1. Përfituesit e pensioneve ESSPROS
2. Sistemi bazë ESSPROS

Niveli i përputhshmërisë me acquis për këto produkte është “plotësisht në përputhje”.

Grafiku 1.4 Përmbledhja e fazës së transmetimit për fushën: Statistikat Sociale dhe Demografike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE



Aktivitetet e Censit të Popullsisë dhe Banesave

Gjatë periudhës Maj - Gusht, 2023, ecuria e punës në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave është si vijon:

- U finalizua pyetësi i Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, si dhe materialet metodologjike si: Manualët e Anketuesit, Kontrollorit, dhe Mbikëqyrësit, Manuali i shkurtuar i Anketuesit, etj.
- U krye testimi i aplikacioneve, përmirësimi dhe zhvillimi i tij pas testimit.
- U realizua trajnimi i përfaqësuesve të INSTAT në 61 bashki;
- U finalizua platforma e mbledhjes së të dhënave për Njësitë Ekonomike Familjare;
- U realizuan takime me kryetarët e bashkive për sigurimin e ambienteve të nevojshme (zyra censi+ambiente trajnimi), si dhe për mbështetje në drejtim të sigurimit të stafit të terrenit;
- Vijoi fushata e komunikimit për rekrutimin e stafit të terrenit, nëpërmjet rrjeteve sociale (facebook dhe instagram), spoteve në radio kombëtare (3 radio kombëtare), spoteve në televizionet lokale (6 TV lokale), shpërndarjes së city light në 10 qarqe, 4 portale online, si dhe shpërndarjes së stendave me materiale informuese në 61 bashki.
- U rekrutua stafi i terrenit: supëvizorë, kontrollorë, anketues, si dhe gjatë katërmujorit referencë është kryer trajnimi i supëvizorëve dhe kontrollorëve.
- U finalizua platforma e mbledhjes dhe transmetimit të të dhënave dhe është kryer konfigurimi i tabletëve.
- U nënshkrua Marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Mbrojtjes / Komanda Mbështetëse lidhur me mbështetjen logjistike të ofruar nga kjo ministri në kuadër të Cens, si dhe u krye transportimi i bazës materiale në 61 bashki.



Fusha statistikore 2: Statistikat Ekonomike

Statistikat ekonomike përfshijnë fushat si: statistikat makroekonomike, statistikat financiare të qeverisë, fiskale dhe sektorit publik dhe statistikat e biznesit, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në hartimin e politikave ekonomike dhe përbëjnë bazën kryesore të informacionit për analiza të mëtejshme mbi zhvillimin dhe ndryshimet strukturore të ekonomisë së vendit.

- Qëllimi kryesor i statistikave ekonomike është që të sigurojnë të dhëna në kohë dhe me cilësi të lartë të treguesve statistikorë, të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave ekonomike si dhe në monitorimin dhe menaxhimin e këtyre fushave.

Agjencitë statistikore përgjegjëse: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Për periudhën Maj-Gusht, 2023, për këtë fushë statistikore, janë 10 aktivitete statistikore që kanë të planifikuar në këtë 4-mujor mbylljen e të paktën një prej fazave të prodhimit statistikor.

Gjatë kësaj periudhe është planifikuar finalizimi (publikimi) i 11 produkteve statistikore dhe është realizuar publikimi për 10 prej tyre.

Këto aktivitete dhe produkte të ndara sipas agjencive rezultojnë si më poshtë:

-INSTAT është përgjegjës për 8 aktivitete statistikore - 6 produkte statistikore

-Banka e Shqipërisë është përgjegjës për 1 aktivitet statistikor - 3 produkte statistikore

-Ministria e Financave dhe Ekonomisë është përgjegjës për 1 aktivitet statistikor - 1 produkt statistikor

*Numri i produkteve statistikore që janë listuar në fazat e mëposhtme (grumbullim / përpunim / publikim / transmetim) është i ndryshëm sepse 1 produkt statistikor mund të ketë në këtë periudhë mbyllje të 1,2,3 ose 4 fazave të prodhimit statistikor.

1. Grumbullimi i të dhënave

- **Planifikuar grumbullimi i të dhënave për 13 produkte statistikore**
- **Grumbulluar të dhënat në kohë për prodhimin e 13 produkteve statistikore të mëposhtme:**
 1. Produkti i Brendshëm Bruto, T1-2023
 2. Llogaritë kombëtare tremujore-Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e prodhimit dhe shpenzimeve.
 3. Statistikat Monetare dhe Financiare, për M5 - 2023
 4. Statistikat Monetare dhe Financiare, për M6 - 2023
 5. Statistikat Monetare dhe Financiare, për M7 - 2023
 6. Statistikat Monetare dhe Financiare, për M8 - 2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

7. Statistikat Financiare të Qeverisë sipas GFSM2014 dhe Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Qeverisë
8. Statistikat e Borxhit të sektorit buxhetor të qeverisë dhe borxhit të garantuar, T2 - 2023
9. Statistikat strukturore të ndërmarrjeve
10. Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve, për T1 - 2023
11. Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve, për T2 - 2023
12. Statistikat e çmimeve në ndërmarrjet ekonomike në nivel tremujor, për T2 - 2023
13. Statistika mbi lejet e ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë, për T2 - 2023


-Për 2 produkte statistikore të dhënat janë grumbulluar me anë të vërojtimeve për të cilat është përdorur metoda PAPI

-Për 3 produkte statistikore të dhënat janë marrë nga burimi administrativ, ku për 1 produkt të dhënat janë mikro, për 2 produkte të dhënat janë makro,

-Për 4 produkte statistikore të dhënat janë marrë nga burime të kombinuara (Vërojtje+Burim administrativ) ku të dhënat për 2 produkte janë Mikro, ndërsa për 2 produkte të dhënat janë të kombinuara (Mikro+Makro).

-Për 4 produkte burimi i të dhënave është i tipit “Tjetër”, ku të dhënat merren nga burime administrative, regjistra, databaza, etj.

Grafiku 2.1 Përmbledhja e fazës së grumbullimit për fushën: Statistikat Ekonomike



2. Përpunimi i të dhënave

- **Planifikuar përpunimi i të dhënave për 15 produkte statistikore**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

➤ **Përpunuar të dhënat në kohë për prodhimin e 15 produkteve statistikore të mëposhtme:**

1. Llogaritë jo-Financiare sipas Sektorëve Institucionale
2. Llogaritë kombëtare tremujore-Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e prodhimit dhe shpenzimeve
3. Llogaritë rajonale
4. Statistikat Monetare dhe Financiare, për M5 - 2023
5. Statistikat Monetare dhe Financiare, për M6 - 2023
6. Statistikat Monetare dhe Financiare, për M7 - 2023
7. Statistikat e Borxhit të sektorit buxhetor të qeverisë dhe borxhit të garantuar, për T2 - 2023
8. Statistikat e produkteve industriale
9. Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve, për T1 - 2023
10. Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve, për T2 - 2023
11. Statistikat e çmimeve në ndërmarrjet ekonomike në nivel tremujor, për T1 - 2023
12. Statistika mbi lejet e ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë, për T1 - 2023
13. Statistika mbi lejet e ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë, për T2 - 2023
14. Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve
15. Regjistri i Njësive Lokale

* Gjatë kësaj periudhe janë për aktivitetin e llogarive rajonale janë prodhuar indikatorë të rinj sikurse kërkohen nga Eurostat: Formimi Bruto i Kapitalit Fiks sipas rajoneve dhe sipas industrive, Kompensimi i Punonjësve sipas rajoneve, Të Ardhurat e Familjeve sipas rajoneve. Këto tregues janë dërguar për herë të parë në Eurostat në formë eksperimentale dhe me status "jo për publikim".

Grafiku 2.2 Përmbledhja e fazës së përpunimit për fushën: Statistikat Ekonomike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE



3. Publikimi i të dhënave

- **Planifikuar për tu publikuar të dhënat për 11 produkte statistikore**
- **Realizuar në kohë publikimi (njoftimi për shtyp, tabela e perditësuar, databaza e perditësuar) për 10 produktet statistikore të mëposhtme:**

1. Llogaritë jo-financiare sipas sektorëve institucionalë
2. Prodhimi i Brendshëm Bruto sipas Rajoneve Statistikore në Shqipëri, 2021
3. Statistikat Monetare dhe Financiare, për M5 - 2023
4. Statistikat Monetare dhe Financiare, për M6 - 2023
5. Statistikat Monetare dhe Financiare, për M7 - 2023
6. Buletini i Treguesve të Borxhit (për T2 - 2023)
7. Indeksi i Kushtimit në Ndërtim për Banesa; Indeksi i Çmimeve të Prodhimit; Indeksi i Çmimeve të Importit (për T1 - 2023)
8. Lejet e Ndërtimit, T1-2023
9. Lejet e Ndërtimit, T2 - 2023
10. Regjistrat e biznesit

- Për 6 produkte statistikore të dhënat janë në nivel kombëtar
- Për 1 produkt statistikor të dhënat janë në nivel rajon/qarku/bashki
- Për 1 produkt statistikor të dhënat janë në nivel qarku
- Për 2 produkte statistikore të dhënat janë në nivel bashkie


- **Të dhënat nuk janë publikuar në kohë për produktin e mëposhtëm:**

- Statistikat e Statistikat Afatshkurtra - Prodhuesit e të mirave, T1 - 2023; Shërbimet, T1 - 2023; Tregtia me Pakicë, T1 – 2023.

Arsyeja e moszbatimit të afatit: U Shty publikimi me vendim të brendshëm për shkak të ngarkesës së punës në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023.



Grafiku 2.3 Përmbledhja e fazës së publikimit për fushën: Statistikat Ekonomike



4. Transmetimi

➤ **Janë transmetuar në Eurostat të dhënat për 11 produktet e mëposhtme:**

1. Llogaritë jo-financiare sipas sektorëve institucionale
2. Produkti i Brendshëm Bruto, T1 - 2023
3. Prodhimi i Brendshëm Bruto sipas Rajoneve Statistikore në Shqipëri, 2021
4. Statistikat strukturore të ndërmarrjeve
5. Statistikat e produkteve industriale
6. Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve, për T1 - 2023: Prodhuesit e të mirave; Shërbimet; Tregtia me Pakicë
7. Indeksi i Kushtimit në Ndërtim për Banesa
8. Indeksi i Çmimeve të Prodhimit; Indeksi i Çmimeve të Importit
9. Lejet e Ndërtimit, T1 - 2023
10. Lejet e Ndërtimit, T2 - 2023
11. Regjistrat e Biznesit


➤ **Përsa i përket nivelit të përputhshmërisë me Eurostat kemi:**

- 2 produkte me nivel të lartë përputhshmërie
- 7 aktivitete me nivel të mesëm përputhshmërie
- 2 aktivitete me nivel të ulët përputhshmërie

Grafiku 2.4 Përmbledhja e fazës së transmetimit për fushën: Statistikat Ekonomike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE



Fusha statistikore 3: Statistikat Sektoriale

Statistikat sektoriale përfshijnë një sërë fushash heterogjene si: statistikat e bujqësisë, peshkimit dhe pyjeve, statistikat e energjisë, transportit, turizmit, statistikat mbi tregtinë e jashtme dhe bilancin e pagesave, statistikat e çmimeve, shkencës dhe teknologjisë, inovacionit.

- Objektivi kryesor i statistikave sektoriale është që të sigurojnë të dhëna në kohë me cilësi të lartë të treguesve statistikore, të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave të përbashkëta mbi fushat e sipërpërmendura si dhe në monitorimin dhe menaxhimin e tyre.

Agjencitë statistikore përgjegjëse: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë

Për periudhën Janar-Prill, 2023, për këtë fushë statistikore, janë 28 aktivitete statistikore që kanë të planifikuar në këtë 4-mujor mbylljen e të paktën një prej fazave të prodhimit statistikor.

Gjatë kësaj periudhe është planifikuar finalizimi (publikimi) i 40 produkteve statistikore dhe është realizuar publikimi për të gjitha produktet sipas planit.

Këto aktivitete dhe produkte të ndara sipas agjencive rezultojnë si më poshtë:

INSTAT është përgjegjës për 23 aktivitete - 36 produkte statistikore

Banka e Shqipërisë është përgjegjës për 5 aktivitete - 4 produkte statistikore

*Numri i produkteve statistikore që janë listuar në fazat e mëposhtme (grumbullim / përpunim / publikim / transmetim) është i ndryshëm sepse 1 produkt statistikor mund të ketë në këtë periudhë mbyllje të 1,2,3 ose 4 fazave të prodhimit statistikor.

1. Grumbullimi i të dhënave



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- **Planifikuar grumbullimi i të dhënave për 68 produkte statistikore**
- **Grumbulluar të dhënat në kohë për prodhimin e 67 produkteve statistikore të mëposhtme:**

1. Statistikat e pyjeve
2. Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga burimi administrative
3. Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga vrojtimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta, për M4 - 2023
4. Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga vrojtimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta, për M5 - 2023
5. Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga vrojtimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta, për M6 - 2023
6. Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga vrojtimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta, për M7 - 2023
7. Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga vrojtimi mujor i aktivitetit të pularive për prodhimin e vezëve (konsum njerëzor), për M4 - 2023
8. Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga vrojtimi mujor i aktivitetit të pularive për prodhimin e vezëve (konsum njerëzor), për M5 - 2023
9. Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga vrojtimi mujor i aktivitetit të pularive për prodhimin e vezëve (konsum njerëzor), për M6 - 2023
10. Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga vrojtimi mujor i aktivitetit të pularive për prodhimin e vezëve (konsum njerëzor), për M7 - 2023
11. Statistikat e qumështit dhe nënprodukteve të tij të gjeneruara nga vrojtimi mujor në fabrikat që grumbullojnë dhe përpunojnë qumështin e lopës, për M4 - 2023
12. Statistikat e qumështit dhe nënprodukteve të tij të gjeneruara nga vrojtimi mujor në fabrikat që grumbullojnë dhe përpunojnë qumështin e lopës, për M5 - 2023
13. Statistikat e qumështit dhe nënprodukteve të tij të gjeneruara nga vrojtimi mujor në fabrikat që grumbullojnë dhe përpunojnë qumështin e lopës, për M6 - 2023
14. Statistikat e qumështit dhe nënprodukteve të tij të gjeneruara nga vrojtimi mujor në fabrikat që grumbullojnë dhe përpunojnë qumështin e lopës, për M7 - 2023
15. Statistikat mbi Çmimet Bujqësore, për M4 - 2023
16. Statistikat mbi Çmimet Bujqësore, për M5 - 2023
17. Statistikat mbi Çmimet Bujqësore, për M6 - 2023
18. Statistikat mbi Çmimet Bujqësore, për M7 - 2023
19. Statistikat e peshkimit
20. Statistikat e peshkimit dhe akuakulturës, për T2 - 2023
21. Statistikat e energjisë elektrike, për T1 - 2023
